



Prishtinë: 30.06.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_196\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_228\_05\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_228\_05\_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 19.06.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2009 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Shaban Basha (shifra e konsumatorit DPZ – 60234) nga Theranda, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të datës 13.05.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimi – Departamenti për Konsumator të datës 24.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 13.03.2008 ekipet inspektuese të KEK-u kane vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të kontrollimit të pikës matëse (njehsorit elektrik), gjatë inspektimit (kontrollimit) të njehsorit elektrik ekipi zyrtare i KEK-ut ka dyshuar se në anën e djathtë të njehsorit elektrik mundë të pengohet matja e saktë e energjisë së konsumuar, dhe kanë kërkuar që ky njehsor duhet të dërgohet në laboratorin e kalibrimit për verifikim.

**Provë:** Procesverbali nr 039194 i datës 13.03.2008

- Me datë 09.05.2008 mbështetur në procesverbalin nr 039194 ekipet zyrtare të KEK-ut për ndërrimin e njehsorëve kanë hekur nga matja e konsumit të konsumatorit njehsorin me nr. 34722413 dhe kanë vendosur njehsorin me nr. 44934515.

**Provë:** Procesverbali nr 0686 për ndërrimin e njehsorit të datës 09.05.2008

- Me datë 07.07.2008 Qendra e laboratorit te kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit nr 34722413 dhe ka konstatuar se për rreth qelqit nga ana e djathtë është futur shiriti filmi, dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik, gjithashtu është konstatuar se blloibat shtetërore janë të falsifikuara dhe numëruesi i njehsorit elektrik është manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 14/7 të datës 07.07.2008
- Me datë 22.10.2008 mbështetur në procesverbalin e laboratorit të kalibrimit ekipet zyrtare te KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të përshkrimit të parametrave teknik për faturim të rikthimit të energjisë së humbur.  
**Provë:** Procesverbali nr 215431
- Me datë 19.12.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPZ08HP04539 në shumë prej 2,850.94 €  
**Provë:** Fatura DPZ08HP04539 të datës 19.12.2009
- Me datë 27.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 21.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit duke u mbështetur në procesverbalet e KEK-ut.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 21.04.2009
- Me datë 13.05.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 05.06.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 05.06.2009
- Me datë 19.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_228\_06\_09.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_228\_06\_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Ve

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar